



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor

Mbledhja nr. 130

Prishtinë, më 19.11.2013, ora 10,00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, Rasim Demiri, Sevdije Lama, Afërdita Berisha-Shaqiri, Boban Todorović, Daut Haradinaj, , Salih Morina.

Mungoi : Liburn Aliu, Nijazi Idrizi

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë: sipas listës së nënshkruar nga pjesëmarrësit.

Stafi mbështetës i komisionit: Bajram Badivuku, Ylber Sherifi dhe Flaka Broqi.

Mbledhjen e kryesoi **Nait Hasani**, kryetar i komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite :

1. Miratimi i rendit të ditës ;
2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së komisionit, të mbajtur më 12.11.2013,
3. Shqyrtimi i projektligjit për trajtimin e ndertimeve pa leje
4. Të ndryshme.

Kryesuesi Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 12.11.2013

Kryetari i Komisionit konstatoi se Komisioni miratoi Procesverbalin e mbledhjes së mbajtur më 12.11.2013.

3. Shqyrtimi i Projektligjit për trajtimin e ndertimeve pa leje.

Kryetari Nait Hasani përshëndeti të pranishmit, dhe falënderoj MMPH, Asociacionin e Komunave, MBZHR për mbështetje, sugjerimet dhe vërejtjet që i kanë bërë për Projektligjin për Trajtimin e Ndertimeve pa leje sidomos për faktin se me këtë Ligj prona do të ndahet nga objekti i ndërtuar pa leje, çka do të thotë se për pronarin e një objekti, mund të vendoset me gjyq nëse është kontestuese.

Arben Çitaku falënderoi Kryetarin dhe deputet dhe theksoi se në lidhje me hartën ortofoto digjitale bazuar në incizimin ajror fotogrametrik në Republikën e Kosovës, fillimisht janë bërë dy data, arsyeja është që në fillim në pjesën veriore të Mitrovicës, KFOR-i nuk e ka lejuar fotografimin dhe pastaj nuk është përfunduar e gjithë aerofotografimi, prandaj data 30 gusht 2013 është marrë si datë përfundimtare.

Nait Hasani edhe një herë ftoi të pranishmit nëse kanë ndonjë ndryshim në lidhje me projektligjin në fjalë dhe propozoi Komisionit të miratohen amendamentet si në vijim :

Amendamenti 1

Neni 1, riformulohet si në vijim:

Qëllimi i këtij Ligji është trajtimi i ndërtimeve pa leje në Republikën e Kosovës.

Amendamenti 2

Neni 2, paragrafi 1, në fund pas fjalës “Kosovës” shtohet “ të datës 30 gusht 2013”.

Paragrafi 3, kalon te dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Shtohet një paragraf i ri :

3.Kategorizimi i ndërtimeve, bazohet në Ligjin për Ndërtim, Kategorizimin I, II dhe III, të zonave urbane dhe Rurale.

Amendamenti 3

Neni 3, në përkufizime fshihen thonjëzat, dhe shtohet një përkufizim i ri : “Investitori - personi ose grup personash fizikë që veprojnë së bashku, të cilët investojnë për krijimin e pronës, në emër të të cilëve regjistrohet për herë të parë.”

Fshihet Nënparagrafi 1.6.

Në nënparagrafin 1.7. dhe në tërë tekstin e projektligjit :

“Regjistri Zyrtar Kombëtar i Ndërtimeve pa Leje” zëvendësohet me “Regjistri shtetëror i Ndërtimeve pa Leje” dhe fjala “kombëtar” zëvendësohet me fjalën “shtetëror”, gjithashtu fshihet “Nr.04/L-110” dhe mbetet vetëm Ligji për Ndërtimin.

Amendamenti 4

Neni 4, në titull dhe në tërë tekstin e nenit fjala “legalizimin” zëvendësohet me “trajtimin”.

Nënparagrafi 1.5. pas fjalës “Publikut” shtohet presje (,).

Nënparagrafi 3.3. riformulohet si vijon :

Vendosja fizike e kopjeve të Regjistrit në zyret komunale dhe ne webfaqen zyrtare, në tërë territorin Republikës së Kosovës gjatë gjithë periudhës sa ligji do të jetë në fuqi, të përditësuara për të reflektuar të gjitha ndryshimet dhe plotesimet e tij;

Nënparagrafi 3.4. fshihet.

Nënparagrafi 3.6. pas fjalës “ndërkombëtare” fshihet “(duke përfshirë dhe jo të kufizuar si UNCHR dhe Agjencioni i Pronave të Kosovës)” dhe vazhdon teksti.

Paragrafi 4 dhe 11, fjala “Pronarët” dhe “pronari” zëvendësohet me “aplikuesit” dhe “aplikuesi”.

Në nënparagrafin 6.1. fjala “Ministri” zëvendësohet me “Ministria”,

Paragrafin 7, pas fjalës “Leje” fshihet “si të kompletuar”.

Nënparagrafi 9.3, fjalja e fundit “të azhuruara për të reflektuar të gjitha amendamentimet e tij” riformulohet : “të përditësuara për të reflektuar të gjitha ndryshimet dhe plotesimet e tij;”

Nënparagrafi 9.5. pas fjalës “ndërkombëtare” fshihet “(duke përfshirë dhe jo të kufizuar si UNCHR dhe Agjencioni i Pronave të Kosovës)” dhe vazhdon teksti.

Paragrafi 13. i këtij Neni, bartet te dispozitat kalimtare dhe përfundimtare.

Nënparagrafi 13.1. fshihet, vazhdon rinumërimi.

Amendamenti 5

Neni 5, në titull fjala “legalizimin” zëvendësohet me “ trajtimin”.

Pas Nënparagrafit 1.1. shtohet një nënparagraf i ri:

Komuna mund të bëjë kontraktimin e shërbimeve shtesë për zbatim efektiv dhe efikas të këtij ligji brenda kohës së lejuar.

Nënparagrafi 1.2.. pas fjalës “Ministria” shtohet “pa kompenzim” dhe vazhdon teksti.

Në fillim të **Nënparagrafit 1.4.** fshihet “Prezantim dhe”.

Paragrafi 3, “pronarët ose shfrytëzuesit” zëvendësohet me “aplikuesit”.

Paragrafi 7, fjala “pronari” zëvendësohet me “aplikuesi”.

Amendamenti 6

Riformulohet titulli i **Nenit 6** :

Përgjegjësitë e Aplikuesve të Ndërtimeve pa Leje ose Njësive brenda Ndërtimeve pa Leje

Ne **Nenin 6** fjalet: “pronarët dhe shfrytëzuesit”, “pronar apo shfrytëzues”, “Pronarët dhe pëdoruesit” zëvendësohet me “aplikuesit”.

Paragrafi 2, fjala “prona” zëvendësohet me “ndërtimi”.

Amendamenti 7

Neni 7, fjala në titull “Legalizimin” zëvendësohet me “trajtimin”.

Paragrafi 1 dhe 2 “shërbime komunale” zëvendësohet me “kyqjen në shërbime në ujë dhe rrymë”.

Fjala “Pronat” zëvendësohet me “ndërtimet”.

Paragrafi 3. në fillim fjala “Shërbimet publike” zëvendësohet me “Ofruesit e Shërbimeve publike”.

Paragrafi 4, fjala “shpejtësi” zëvendësohet me “kohe”.

Paragrafi 6, fshihet.

Amendamenti 8

Titulli i **Kreut III,** “PROCESET E LEGALIZIMIT” riformulohet “PROCEDURAT TRAJTIMIT”.

Neni 8, nënparagrafi 1.4. fshihet.

Nënparagrafi 1.6. fjala “i kompletuar” zëvendësohet me “i përfunduar”.

Paragrafi 1.8. “prona” zëvendësohet me “ndërtimi”.

Nenparagrafi 1.9, fshihet.

Paragrafi 3, “Pronarët” zëvendësohet me **“aplikuesit”**.

Amendamenti 9

Neni 9, Nenparagrafi 1.2 dhe 1.3. fshihen.

Nenparagrafi 1.4., riformulohet si vijon :

Ndërtesa është e kompletuar dhe plotëson kërkesat themelore për shendet dhe siguri sipas nenit 13 te ketij Ligji.

Amendamenti 10

Neni 10, riformulohet si vijon :

Kërkesat për Dokumente në Mbështetje të Aplikacionit për Legalizim

1. Aplikacioni për legalizim do të dorëzohet në formularin standard të aplikimit dhe do të përmbajë dokumentet e mëposhtme:

1.1. Për ndërtimet e përfunduara të kategorisë së parë (I), tre (3) kopje të shtypura dhe digjitale të:

1.1.1. Planit të Situacionit;

1.1.2. Planit të Parcelës;

1.1.3. Plani për mbrojtje nga zjarri për objektet me sipërfaqe më të madhe se katërqindpesdhjet metra ne katrore (450 m²) ;

1.1.4. Bazët së themeleve, kateve dhe kulmit;

1.1.5. Prerjes në përpjesë nje me pesedhjetë (1:50);

1.1.6. Dukjeve, duke përfshirë edhe ndërtesat fqinje;

1.1.7. Bazave dhe prerjeve të konstruksionit;

1.1.8. Projektit të instalimeve të ujit;

1.1.9. Projektit të instalimeve të rrymës;

1.1.10. Projektit të instalimeve mekanike;

1.1.11. Fotot e objektit ndertues se paku katër (4) foto qe tregojnë te gjitha dukjet e objektit.

1.2. Nga kategoria e I-re përjashtohen shtëpit individuale te banimit deri njeqindmetra ne katrore (100 m²) dhe objektet bujqesore deri më katërqind metra ne katrore (400 m²), përveç pikës 1 te ketij Neni duhet te plotësojë :

1.2.1 Planin e Situacionit

1.2.2. Planin e Parcelës;

1.2.3. Përshkrimin teknik që perfshinë të dhënat për siperfaqen ndërtuese, numrin e kateve, lartësia e hartuar nga Arkitekti apo Inxhinjeri i ndërtimit.

1.2.4. Fotot e objektit ndertues se paku kater (4) foto qe tregojnë te gjitha dukjet e objektit.

1.3. Për ndërtimet e përfunduara te kategoris se II-te, tre (3) kopje të shtypura dhe digjitale të :

1.3.1. Planit të Situacionit;

1.3.2. Planit të Parcelës;

1.3.3. Projektit për Mbrojtje nga Zjarri ;

1.3.4. Bazës së themeleve, kateve dhe kulmit;

1.3.5. Prerjes në përpjesë nje me pesedhjetë (1:50);

1.3.6. Dukjeve, duke përfshirë edhe ndërtesat fqinjë;

1.3.7. Bazave dhe prerjeve të konstruksionit;

1.3.8. Raporti i i stabilitet te strukturës,

1.3.9. Raporti i instalimeve të ujit;

1.3.10. Raporti i instalimeve të rrymës;

1.3.11. Raporti i instalimeve mekanike;

1.3.12. Së paku dy (2) fotografi të ndryshme të ndërtimit, të bëra gjatë ndërtimit.

1.4. Për ndërtimet e përfunduara te kategoris së trete (III-ë), rregullohet me udhezim administrativ nga Ministria.

1.5. Dëshmi për pagesën e taksës administrative prej njëqind euro (100 €).

Amendamenti 11

Neni 11, fshihet.

Amendamenti 12

Neni 13, paragrafi 1. në rreshtin e fundit lidhesja **“dhe”** zevendesohet me presje (,).

Nenparagrafi 2.1. ne fund fshihet **“sa që e bën të qartë se aplikimi nuk është bërë në mirëbesim”**.

Nenparagrafi 2.2. fshihet.

Pas nenparagrafit 2.4 shtohen pesë nenparagrafë të rinj :

2.5. është i ndërtuar në pronë publike, përkatësisht në zonë me interes publik, në përputhje me ligjet ne fuqi;

2.6. është i ndërtuar në zonën e mbrojtur të natyres dhe parqeve nacionale;

2.7. është i ndërtuar në korridoret e infrastrukturës në fushën e energjetikës,transportit dhe hidrosistemit;

2.8. është i ndërtuar në zonat e mbrojtura dhe zonat e veçanta të trashëgiminë kulturore.

2.9. është i ndërtuar në tokën bujqësore nën sistem të ujitjes dhe komasacionit.

Paragrafi 3, pas fjalës **“aplikimit”** fshihet **“por dallimi nuk paraqet keq-besim”**.

Amendamenti 13

Neni 14, pas paragrafit 3, shtohet një paragraf i ri :

Nga taksa për legalizim lirohen shtepitë individuale të banimit deri njëqindmetra ne katror 100m2, përfituesit e skemës sociale dhe objektet bujqësore deri katërqind metra ne katrore (400m2) sipas Nenit 10 Nënparagrafi 1.3.

Amendamenti 14

Neni 15 riformulohet :

Procedurat e nxjerrjes së vendimit dhe efektet juridike të legalizimit të Objekteve pa Leje

1. Për çdo aplikacion i cili i plotëson të gjitha kriteret, organi kompetent nxjerr vendim për legalizim të ndertimit pa leje.
2. Vendimi për legalizim bazohet në dokumentet e ofruara nga aplikuesi dhe në gjendjen ekzistuese të ndertimit në teren.
3. Vendimi për legalizim të ndertimit nuk ka efekt juridik në pronësinë dhe të drejtat tjera sendore në ndertimin për të cilin është nxjerr ky vendim dhe në parcelën kadastrale në të cilën është ndertuar.
4. Vendimi për legalizim do të lëshohet brenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e paraqitjes së të gjitha dokumenteve të përcaktuara me këtë ligj.
5. Nëse, gjatë shqyrtimit, organi kompetent gjenë se ka mangësi në dokumentet e kërkuara sipas Nenit 10 të cilat parandalojnë procedimin e mëtejshëm të aplikacionit, organi kompetent do të njoftojë aplikuesin, i cili duhet të plotësojë dokumentacionin për të eliminuar mangësitë brenda tridhjetë (30) ditësh.
6. Nëse mangësitë nga Paragrafi 5 i këtij neni nuk evitohen, organi kompetent refuzon aplikacionin.
7. Vendimet për të gjitha aplikacionet duhet të merren brenda tre (3) viteve pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

Amendamenti 15

Neni 16, paragrafi 3, pas fjalës **“Ligjin”** fshihet **“Nr.03/L-202”**.

Paragrafi 4, në fund **“me këtë ligj”** zëvendësohet me **“në pajtim me Ligjin për Konfliktet Administrative”**.

Amendamenti 16

“Article 17” zëvendësohet me **“Neni 17”**.

Neni 17, riformulohet si vijon :

1. Nëse aplikuesi në një ndertesë në bashkëpronësi, të ndertuar pa leje paraqet një kërkesë për t’u përfshirë në regjistrin komunal të ndërtimeve pa leje, e tërë ndertesë në bashkëpronësi do të përfshihet në regjistrë.
2. Nëse aplikuesi i një njësie të ndertuar pa leje në një ndertesë në bashkëpronësi të ndertuar me leje, paraqet një kërkesë për t’u përfshirë në regjistrin komunal të ndërtimeve pa leje, aplikacionit duhet ti bashkangjitet pëlqimi i pronarëve i cili duhet të jetë i verifikuar tek organet kompetente.

Amendamenti 17

Kreu V dhe kreu VI bashkohen.

KREU V

DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 18, Paragrafi 2 riformulohet si vijon :

Të gjitha aplikacionet tjera për legalizim, që janë dorëzuar në komuna para hyrjes në fuqi të këtij ligji, për të cilat nuk është nxjerrë vendimi, do të procedohen në pajtim me këtë ligj.

Fshihet paragrafi 3.

Amendamenti 18

Neni 19, Paragrafi 1. fjala **‘leja’** zëvendësohet me **‘vendimi’** dhe fjala **“pronë”** zëvendësohet me **‘ndërtimin pa leje’**.

Paragrafi 2. **“ose çdo pronar i të ndërtimit pa leje”** zëvendësohet me **“i ndërtimit pa leje”** dhe vazhdon teksti

Paragrafi 3, në fund fjala **“pronari”** zëvendësohet me **“investitori”**.

Paragrafi 4, fjalët **‘Pronarët’** dhe **“pronari”** zëvendësohen me **“investitorët”** përkatësisht **“investitori”**.

Amendamenti 19

Neni 20, paragraf 1, riformulohet :

Ndërtimet të cilat kanë filluar pas hartës ortofoto digjitale të datës 30 gusht 2013, nuk kualifikohen për legalizim sipas këtij ligji.

5. Të ndryshme

Në pikën të ndryshme deputetja **Sevdije Lama** inicioi për mbledhjen e radhës të ftohen dy Ministrat, Ministri i Mjedisit dhe Planifikim Hapësinor dhe Ministri i Bujqësisë, rreth raportit të progresit, për çka Komisioni përkatësisht Kryetari i Komisionit me rastin e caktimit të mbledhjes së radhës në fillim të dhjetorit, do ti ftoi për mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 13,00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit,
Nait Hasani